

University for Business and Technology in Kosovo

UBT Knowledge Center

Theses and Dissertations

Student Work

Winter 12-2015

Projektimi i objekteve shoqërore - Shkollë Fillore

Emel Vërbiqi

University for Business and Technology - UBT

Follow this and additional works at: <https://knowledgecenter.ubt-uni.net/etd>



Part of the [Architecture Commons](#)

Recommended Citation

Vërbiqi, Emel, "Projektimi i objekteve shoqërore - Shkollë Fillore" (2015). *Theses and Dissertations*. 1018.
<https://knowledgecenter.ubt-uni.net/etd/1018>

This Thesis is brought to you for free and open access by the Student Work at UBT Knowledge Center. It has been accepted for inclusion in Theses and Dissertations by an authorized administrator of UBT Knowledge Center. For more information, please contact knowledge.center@ubt-uni.net.

ABSTRAKT

Emel Vërbiqi , Arkitekturë, Kolegji për Biznes dhe Teknologji

Abstrakt i shkallës Bachelor të studimeve

Projektimi i Ndërtesave Shoqërore - Shkollë Fillore

Qëllimi i punimit tim të diplomës ka qenë studimi i këtij lloji të objekteve dhe periudhave të arkitekturës moderne dhe bashkëkohore në projektimin e Shkollave. Në fillim kam analizuar format e hershme arkitektonike dhe funksionin e pastaj zhvillimin e këtyre formave dhe diferencat ndërmjet shkollave të kohës së hershme dhe atyre të kohës bashkëkohore. Dallimet e tyre si nga ana arkitektonike, poashtu dhe nga ana funksionale. Së dyti kam analizuar lokacionin-terrenin si dhe zonën klimatike se ku janë ndërtuar këto objekte. Në këtë rast vie në përfundim se të gjitha këto luajnë rol të madh në zgjidhjen funksionale por edhe atë estetike varësisht nga lokacioni dhe klima se ku janë paraparë për ndërtim shkollat, sepse lokacioni-terreni e percakton zgjidhjen arkitektonike. Së treti në materializimin e këtyre objekteve se çka ndikon, dhe si përfundim kam nxjerrur se materializimi i tyre duhet të jetë në harmoni me mjedisin që e rrethon , karakterin dhe funksionin që përmban ky lloj i objektit . Në këtë rast objekti të bashkëveprojë dhe të ketë ndërthurje me ambientin e jashtëm, por dhe ambienti i jashtëm aty ku ka mundësi të inkorporohet edhe brenda tij, pra të bëjmë një lidhje mes objektit dhe natyrës. E fundit dhe një prej elementeve të rëndësishme ka qenë pas gjithë analizave të bëra përzgjedhja e formës ideale, ku në secilin rast jam diktuar nga funksioni i objektit dhe lokacioni të cilin kam përzgjedhur për objektin – rasti një lagje pa shkollë fillore . Duke u nisur nga vetë lokacioni, formës së objektit i ka paraprirë zgjidhja sa më adekuate e funksioneve të shkollës si dhe shpërndarja e tyre në proporcion me hapësirën se ku kam planifikuar ta projektoj.

MIRËNJOHJE /FALËNDERIMET

Si studente e UBT-s së pari në vecanti i detyrohem me një falënderim të veçantë:

mentorit tim Dr. Sc.Binak Beqaj , si profesorë i fakultetit në UBT – departamentit të Arkitekturës, ku unë kam vijuar studimet për përkushtimin dhe ndihmesën.

Gjatë këtyre 3 vite , frytdhënëse dhe shumë të dobishme e profesionale në të njëjtën kohë kam mësuar dhe studiuar më shumë se sa profesionin.

Do ti mbetem mirënjohës për përkushtimin, kohën, sygjerimet dhe këshillat të cilat m’i ka ofruar gjatë shqyrtimit të problemit dhe ofrimit të zgjidhjes dhe finalizimit të gjithë këtij studimi dhe pune disa mujore.

I falenderohem dhe i mbetem mirënjohës dhe profesorëve Dr. Sc. Muhamet Ahmeti .

Ju falënderohem të gjithë kolegëve, shokëve dhe shoqeve që gjatë këtyre viteve të studimit nuk kanë hezituuar për asnjë moment të më ofrojnë ndihmë në momentet kur unë e kam ndjerë nevojën e tyre.

Posaçërisht, një falenderim dhe mirënjohje të veçantë i detyrohem prindërve të mi, të cilët më janë gjendur pranë në secilin gjatë këtyre viteve të studimeve të mia. Ju falënderohem dhe ju mbetem përjetësisht mirënjohës për ndihmën e pakufishme në secilin hap që unë kam ndjekur, për gjithë sakrificat e tyre, mundin, përkushtimin, këshillat prindërore dhe tolerancën e tyre ndaj meje. Shpresoj që një ditë të ju bëj të ndiheni krenar siç unë jam krenar që jeni pjesë e jetës sime.

PËRMBAJTJA

LISTA E FIGURAVE

LISTA E TABELAVE

FJALORI I TERMAVE

1. HYRJE.....	1
2. HULUMTIMI I LITERATURËS.....	2
2.1. Zhvillimi i shkollave (historiku i shkollave).....	2
2.2. Historiku dhe specifikat e materialeve të përdorura	3
2.3. Architectural Standard - Neufert	5
2.4. Udhëzues për normat dhe standardet e ndërtesave shkollore.....	5
3. METODOLOGJIA.....	6
3.1. Lokacioni dhe rëndësia e tijë	6
4. PROGRAMI I DETYRËS PROJEKTUES.....	7
4.1. Grupacioni hyrës	7
4.2. Grupacioni i klasave	7
4.3. Grupacioni ekonomik	7
4.4. Grupacioni i administratës	7
4.5. Grupacioni i kabineteve	8
4.6. Grupacioni i kthinave sanitare	8
4.7. Komunikimi i përdhësës	8
5. PËRSHKRIMI-ANALIZA E SITUACIONIT.....	9
6. PËRSHKRIMI TEKNIK.....	10
6.1. Shkollat Filllore –Arkitektonik dhe funksione.....	10
6.2. Ideja dhe Koncepti.....	11
6.3. Etazhiteti.....	11
6.4. Destinimi i Sipërfaqeve në kuadër të parcelës.....	11
6.5. Sipërfaqet e Objektit.....	11
6.6. Qasja në Lokacion.....	12

6.6.1. Konstruksioni.....	12
6.6.2. Mbulesa.....	12
6.6.3. Fasada.....	12
6.6.4. Mveshjet finale të pllakave jashtë.....	12
6.6.5. Mveshjet finale të dysHEMEVE brenda.....	12
6.6.6. Shkallët.....	13
6.6.7. Dyert dhe dritaret.....	13
6.7. Izolimi i Objektit.....	13
6.8. Përshkrimi i Enterierit-Koncipimi i Funksioneve.....	14
6.9. Orientimi i Kthinave.....	14
6.10. Ndriçimi	14
7. REFERENCAT.....	15
8. BIBLIOGRAFIA.....	16

LISTA E FIGURAVE

Figura 1. UBT Logo.....	1
-------------------------	---

LISTA E TABELAVE

Tabela 1. Destinimi i sipërfaqeve në kuadër të parcelës.....	11
Tabela 2. Sipërfaqet e objekteve.....	11

1. HYRJE

Shkollat janë organizuar si hapësira për mësimdhënie dhe mësimnxënie. Klasat, ku mësuesit japin mësim dhe nxënësit mësojnë, janë të një rëndësie qendrore. Klasat mund të specifikohen për subjekte të caktuara, të tilla si klasat laboratorike për arsim shkencë dhe punëtori për arsimin e arteve industriale. Shkollat tipike kanë shumë dhoma dhe fusha të tjera, të cilat mund të përfshijnë: Auditoriume, Zyra për punët puna administrative të shkollës

Biblioteka ku nxënësit shikojnë libra dhe revista, Laboratore kompjuterike etj.

Duke filluar nga viti 1999, arsimi në Kosovë iu nënshtua reformave në të gjitha nivelet: nga arsimi dhe edukimi parashkollor e deri në universitet. Këto reforma kishin për synim përshtatjen e arsimit në Kosovë sipas standardeve bashkëkohore evropiane e botërore.

Ligji për arsimin - Arsimi është i detyrueshëm për të gjitha moshat nga 6 deri në 15 vjeç.

Edukimi parashkollor - Sistemi i edukimit parashkollor ndahet në tri nivele : klasa parafillore (për fëmijët e moshës 5 vjeçare)

Arsimi Fillor dhe Arsimi i mesëm i ulët - Sipas Ligjit për arsimin fillor dhe të mesëm në Kosovë, Edukimi Fillor (1-5) dhe i mesëm i ulët është i obliguar për të gjithë. Shkollimi i detyruar fillon kur fëmija ka mbushur moshën 6 vjeç (mosha minimale e arsimit të obliguar). Arsimi i mesëm i ulët është faza e dytë e arsimit bazë të detyruar dhe përfshin klasat 6-9, gjerësisht moshat 12 deri në 15 vjeç.

2. HULUMTIMI I LITERATURËS

2.1. ZHVILLIMI I SHKOLLAVE (Historiku i shkollave)

Koncepti i grupimit të studentëve së bashku në një vend të centralizuar për të mësuar ka ekzistuar që nga lashtësia klasike. Shkollat formale kanë ekzistuar të paktën që nga Greqia e lashtë , Romën e lashtë , India e lashtë , dhe Kina e lashtë . Perandoria Bizantine ka pasur një sistem të themeluar shkollimit duke filluar në nivelin fillor. Sipas traditave themelimi i sistemit të arsimit fillor filloi në vitin 425 pas Krishtit .Sistemi arsimor Bizantine vazhdoi deri në rrëzimin e perandorisë në vitin 1453 pas Krishtit.

Islami ishte një tjetër kulturë që ka zhvilluar një sistem shkollor në kuptimin modern të fjalës. Theksi është vënë në dije, e cila kërkonte një mënyrë sistematike e mësimdhënies dhe përhapjen e njohurive . Në fillim, xhamitë shërbyen për dy aktivitetet : fetare dhe të mësuarit, por nga shekullit IX filluan të prezentohen **medreset** , një shkollë që ishte ndërtuar në mënyrë të pavarur nga xhamia. Medreseja Nizamiyya konsiderohet me konsensus të dijetarëve të shkollave të hershme të mbijetuar, e ndërtuar më 1066 AD nga Emir Nizam el-Mulk.Nën osmanët, qytetet e Bursës dhe Edirne u bënë qendrat kryesore të të mësuarit.

Në Evropë, universitetet shfaqn gjatë shekullit të 12-të . Gjatë Mesjetës dhe periudhës së hershme moderne, qëllimi kryesor i shkollave (në krahasim me universitetet) ishte për të mësuar gjuhën latine .Pas kësaj, kurrikula shkollore ka zgjeruar gradualisht për të përfshirë shkrim e këndim në gjuhën e folur, si dhe lëndët teknike, artistike, shkencore dhe praktike.

Vijimi i detyrueshëm i shkollës u bë e zakonshme në pjesë të Evropës gjatë shekullit të 18-të. Në shkollat më të hershme publike në Shtetet e Bashkuara dhe vende të tjera ishin shkolla një dhomëshe .

2.2. HISTORIKU DHE SPECIFIKAT E MATERJALEVE TË PËRDORURA

Materialet në ndërtim përgjatë gjithë historisë kanë qenë ngushtë të lidhura me vet zhvillimin e njerëzimit, kështu duke i siguruar njeriut strehim, qoftë ai i përkohshëm apo i përhershëm. Materialet të cilat do të hasen gjatë të gjitha ndërtimeve janë: guri, druri, xhami, metali dhe betoni, si dhe në një mori rastesh tjera dhe materialet inovative të dy dekadave të fundit, të cilat kanë derivuar nga zhvillimi i hovshëm teknologjik si dhe lindja e materialeve të shumta vit pas viti ku si qëllim primar ka pasur reduktimin e shpenzimeve në ndërtim si dhe ruajtjen e energjisë së objektit. Dhe si rezultat i përdorimit të këtyre materjaleve rritet kualiteti i objektit si tërësi por edhe kualiteti i jetesës në të. **Druri** dhe nënproduktet e tij, janë burimi më i rëndësishëm i përdorur në procesin e ndërtimit. Për mijëra vjet ka qenë njëri nga materialet më popullore së bashku me gurin dhe baltën. Përgjatë historisë është përdorur për shkak të rezistencës së tij dhe peshës së lehtë, druri i ka disavantazhet e tij prandaj në ndërtim është zëvendësuar nga betoni dhe çeliku. Duke iu falenderuar arkitekturës ekologjike përdorimi i drurit aktualisht ka një ringjallje në përdorimin e tij si material ndërtimor. Druri është një bimë e gjallë dhe pothuajse menjëherë pasi ai të prehet mund të përdoret. Mund të thuhet se druri është i vetmi material ndërtimor i rinovueshëm, edhe pasi që ai të jetë përdorur mund të riciklohet dhe të përdoret përsëri. Druri në vetvete përfaqëson ruajtjen e energjisë, respektin për mjedisin si dhe ruajtjen e ekuilibrit ekologjik. Druri mund të ndahet në dy grupe: në halor – të butë e rrëshinor, dhe gjethegjërë – më i fortë dhe përgjithësisht dru gjethegjërës siq janë: lisi, bingu, mështekna, ahu etj. Ka lloje të ndryshme të drurit siq ka dhe lloje të ndryshme të pemëve, por të gjithë llojet kanë disa veti të përbashkëta të cilat spjegojnë përdorimin e tyre në arkitekturë. Në përgjithësi, struktura qelizore e drurit është e lehtë por e fortë. Ai mund të absorbojë një sasi të madhe të tensionit, presionit dhe përkuljes në ngarkesa. Druri nga pemët halore është më pak i përshtatshëm në ngjeshje dhe tension kurse disa pemë gjethegjëra-gjethegjërës kanë një strukturë më të detajizuar qelizore, më të dendur dhe më të fortë. Edhe pse është një material i djegshëm, druri ka një rezistencë të pranueshme ndaj zjarrit në saje të djegjes së tij periferike – djegja nga jashtë brenda është e ngadalshme. Qëndrueshmëria e tij është e lartë nëse arrin të trajtohet në mënyrën e duhur, Edhe pse kur përdoret jashtë dyerve druri është i ndjeshëm ndaj ndryshimeve klimatike si dhe kur dëmtohet nga myku apo insektet. Ngjyra dhe tekstura e sipërfaqes së tij, e bënë drurin material sensual dhe të ngrohtë. Tradita e gjatë e përdorimit të drurit, ka rezultuar me

një numër të madh metodash në ndërtim dhe ka çuar në prodhimin e shumë nënprodukteve të tij. **Xhami** si material njihet qysh nga vitet 10000 pes. Prerja e parë e xhamit është hasur në Egjipt rreth viteve 1500 pes dhe xhami i parë transparent u shfaq gjatë viteve 1500 pes. U shfaq në Siri në shek. III dhe IV pes kur dhe u zhvilluan teknikat e para në lidhje me prodhimin e tij, e më pastaj u përhap edhe në Romë dhe Greqi. Shek. XX hasi në përdorimin e gjerë të xhamit, sidomos në fasadë. Procesi i prodhimit të xhamit fillon me përzierjen e materialeve bazë dhe temperature e shkrirjes është rreth 1200°C dhe 1650°C në varësi të përbërjes. Përzierja e tejdukshme pasi që ftohet dërgohet për në kallëp, shtrihet, shtypet dhe pluskon. Pluskimi është teknika e cila përdoret zakonisht për të prodhuar xham të sheshtë dhe pastaj ftohet. Xhami është material i cili në gjendjen e tij natyrore ka ngjyrë të gjelbër ose karameli, varësisht nga papastërtitë që ai përmbanë. Duke i shtuar substanca të tjera xhami bëhet transparent dhe këto karakteristika bëjnë që xhami të gjej përdorim në arkitekturë, duke përfshirë dhe xhamin e tejdukshëm dhe me ngjyrë. Xhami nuk ofron izolim të mirë termik apo akustik, dhe në mënyrë që të arrihet kjo, xhami lustruhet, dritarja formohet nga dy xhama dhe një hapësirë ajri në mes. Xhami reagon mirë në rast të ndryshimeve në temperaturë, për aq sa temperatura ndryshon në mënyrë graduale. Brishtësia është një tjetër karakteristikë e xhamit, ndonëse përparimet teknologjike kanë avansuar në zhvillimin e llojeve të ndryshme të xhamave që janë më të fortë. Ekziston një shumëllojshmëri e xhamave që mund të përdoren në ndërtim.

Përdorimi i metalit dhe i lidhjeve metalike daton mijëra vjet më parë dhe erdhi me zhvillimin teknik. Është përdorur në periudha të ndryshme historike që nga koha e bronzit dhe hekurit. Për shekuj me rradhë, metali është përdorur për të bërë vegla, mjete apo armë të ndryshme. Fillimisht në objekte është përdorur si mjet ndihmës për konstruksione dhe si material dekorativ, por gjithçka ndryshoi me përhapjen e përdorimit të gjerë të çelikut dhe aluminit në ndërtim gjatë shek. XIX. Kategoria e parë përfshinë hekurin e farkëtuar dhe çelikun, kurse kategoria e dytë përfshinë aluminin, zinkun, plumbin dhe bakrin së bashku me lidhjet e tyre. Suksesi i përdorimit të metalit në ndërtim qëndron tek vetitë e tij të shumta si: fortësia, rezistenca në shtypje dhe tension, fleksibiliteti dhe përshtatshmëria e tij në riciklim. Është material që e përçon mirë elektricitetin dhe nxehtësinë. Metali përdoret në ndërtim për shkak të vetive të tij mekanike, siq janë rezistenca në tërheqje dhe rezistenca në shtypje. Disa metale mund të ngjiten me njëra tjetrën ku me këtë rast bëhen edhe më të fortë. Megjithatë, ka procese të cilat dhe mund ti dëmtojnë vetitë e tyre. Edhe pse është zjarrdruues, një rritje në temperaturë mund ta bëjë metalin

ta humb rezistencën mekanike të tij. Ndryshku poashtu është një reaksion i zakonshëm tek metalet, nëse metale të tjera apo uji intervenojnë ky proces bëhet edhe më i dëmshëm dhe atëherë ndodh korrozioni. Për të shmangur korrozionin është e nevojshme që materiali të galvanizohet ose lyhet. Hekuri dhe çeliku janë metalet që gjejnë përdorimin më të madh në ndërtim. Metali ferror me përmbajtje karboni më pak se 2% njihet si çelik. Çeliku është me elastik sesa hekuri dhe mund të saldohet, kurse hekuri ndryshket dhe duhet të mbrohet. Zinku dhe bakri janë lehtësisht të punueshëm dhe janë rezistent ndaj ujit dhe shpesh përdoren në fasadë. Alumini është metal me peshë të lehtë por me densitet të ulët, përdoret në ndërtim aty ku nevojitet pesha të jetë e lehtë dhe të rezistojë ujit, poashtu edhe si element i fasadave.

Mund të thuhet se sot **betoni** është materiali ndërtimorë që gjen përdorimin në shumicën e objekteve. Përdorimi dhe zbatimi i tij i gjerë në ndërtim në pothuajse të gjitha objektet arkitektonike është për shkak të disa arsyeve themelore, siç janë zbulimi i Portland çimentos dhe zbulimi i betonit të përforcuar. Bollëku dhe kosto e ulët e përbërësve të tij, është një arsye tjetër në përdorimin e tij të gjerë dhe të suksesshëm në ndërtim. Betoni i përforcuar, i cili ka veti tjera sot në krahasim duke bashkëvepruar edhe me rrjetën e çelikut. Ka filluar të përdoret në mes të shek. XIX dhe u shfaq në vitin 1855 gjatë Ekspozitës Univerzale në Paris. Monier dhe Coignet shfaqën një numër të madh të ndërtimeve nga ky lloj materiali në po të njejtën Ekspozitë në Paris në vitin 1867. Sot betoni kryesisht bëhet nga Portland çimentoja, materialet e thata si – rëra dhe zhavorri si dhe uji. Ka një dallim në mes betonit të freskët dhe atij të vendosur. Vetitë e tij përfshijnë konsistencën, butësinë dhe homogjenitetin, varësisht nga lloji i çimentos që është përdorur, sasia e ujit si dhe aditivëve-shtesave. Pas disa proceseve, pasi që betoni vendoset ai bëhet një material rezistent dhe i qëndrueshëm. Mundësia e përdorimit të elementeve të parafabrikuara nga betoni me të njejtin garancion, ka bërë që kjo të kontribuojë në popullaritetin e tij në ndërtim. Betoni gjenë përdorim të jashtëzakonshëm në ndërtimin e shtëpive.

3. METODOLOGJIA

Gjatë gjithë procesit të punimit të diplomës dhe projektit që do të shtjellohej fazë pas faze, në fillim është përzgjedhur lokacioni se ku ky objekt do të parashihet të ndërtohet dhe pastaj janë bërë analizat e lokacionit se ku do të parashihej të ndërtohet ky objekt. Të gjitha këto kanë ardhur si rezultat i bashkërendimit të njohurive të fituara nga literatura ndërkombëtare , vendore , si dhe njohuritë e fituara gjatë studimeve dhe më herët, të cilat më kanë ndihmuar në përpunimin dhe finalizimin e punimit të diplomës.

3.1 LOKACIONI DHE RËNDËSIA E TIJ

Secila ndërtes vendoset në një lokacion (truall) të caktuar . Lokacioni mund të jet : tokë bujqësore apo ndërtimore, teren i rafshër apo i pjerët, teren i hapur apo i kufizar në anë të caktuara, në qendër të zonës apo në periferi, me infrastruktur adekuate apo pa të . Të gjitha këto janë disa nga kushtet urbanes dhe inxhinierike që përcaktojnë kualitetin e truallit për ndërtim . Jo qdo lokacion apo truall është i gatshëm për ndërtim , prandaj në terene duhen të bëhen punë përgatitore .

4. PROGRAMI I DETYRËS PROJEKTUESE

4.1 Grupacioni hyrës

Erëmbrojtësi	19.4 m ²
Holli hyrës /Hapësira për shum qëllime	200 m ²
Sigurimi	9.60 m ²
Bife	51.90m ²

4.2 Grupacioni i klasave

Klasat 1 klasë = 50m² për 20 nxënës

4.3 Grupacioni ekonomik

Hyrja Ekonomike :	7.50 m ² / Erëmbrojtësi
Trafostacioni i rrymës	20 m ²
Nënstacioni i nxemjes / Depoja për material për ngrohje	200 m ²
Stacioni i pompimit të uji	20 m ²
Depo e inventarit të ri	184 m ²
Depo e inventarit të vjetër	167 m ²
Kthina për mirëmbajtje (punëtor)Shtëpiaku	20 m ²
Depo e materialit shpenzues	34 m ²
Nyjet sanitare : Femra WC + lavaman	
Meshkuj WC + lavaman	8.11 m ²

4.4 Grupacioni i administratës

Hyrja administrative :	7.50 m ² / Erëmbrojtësi
Salla për arsimtarë	63.50m ²
Administrata : Drejtori	33.80 m ²
Sekretari	18.90 m ²
Pedagogu	20 m ²
Psikologu	20 m ²

Juristi	18.80 m ²
Financieri	19.90 m ²
Salla për takime	31.80 m ²
Arkiva	31.50m ²
Fotokopje	8 m ²
Nyjet sanitare për personel : Femra 2 WC + 2 lavaman	10.70 m ²
Meshkuj 2 WC + 2 lavaman	10.70 m ²

4.5 Grupacioni i kabineteve

-Biologji (Demonstrim - Praktik)	71m ²
-Fizikë (Demonstrim - Praktik)	71m ²
-Kimi (Demonstrim - Praktik)	71m ²
Kabineti i vizatimit	92 m ²
-Depo për material	15 m ²
Kabineti i muzikës	92 m ²
-Depo për instrumente	15 m ²
Kabineti i gjuhëve të huaja	71 m ²
-Depo për material	10 m ²
Kabinet i informatikes	71 m ²
-Depo për material	10 m ²
Hapësira për kreativitet	145.40 m ²
Bibloteka	146 m ²

4.6 Grupacioni i kthinave sanitare

Nyjet sanitare për nxënës Femra : 3 WC + 3 lavamane	23.30 m ²
Meshkuj: 3 WC + 3 lavamane+ 3 pisoar	23.30 m ²
Hendikep: 1/Në kat	4.5 m ²

4.7 Komunikimi i përdhësës

Shkallët dhe ashensori Të llogariten për lartësin e Katit H= 280 cm	16.2 m ²
---	---------------------

5. PËRSHKRIMI - ANALIZA E SITUACIONIT

Lokacioni i përzgjedhur për projektimin e "Shkollës fillore " ndodhet në lagjën " Shtatë Shtatori" në qytetin e Mitrovicës .Parcela e përzgjedhur ka një sipërfaqe të konsiderueshme prej $16364.31\text{m}^2/163.64\text{A}$,terreni i parapar për ndërtim si dhe lokacioni është relativisht i rrafshët me një pjerrtësi tepër të vogël. Lagjja "Shtatë Shtatori " gjendet në pjesën Lindore të qytetit të Mitrovicës. Në anën e djathtë të rrugës gjendet parcela e përzgjedhur për proektin e shkollës .

Duke patur parasysh standardet që janë të caktuara për disa funksione që i përmban një objekt i kategoris së till dhe kushteve që na ofron lokacioni në aspektin e orientimit me anët e botës , është bërë edhe orientimi i objektit që të ket kushte sa më të përshtatshme , të ket drit të mjaftueshme etj. Tereni është i hapur në të katër anët . Ka kyqje nga rruga kryesore me mundesi dalje edhe në rrugët dytësore të lagjës . Vendosja e objektit në lokacion është në harmoni me objektet e ndërtuara për rreth lokacionit.



6. PËRSHKRIMI TEKNIK

6.1. SHKOLLA FILLORE – ARKITEKTURA DHE FUNKSIONET

Arkitektures I është bër një analize e veçantë në menyr që të ket karakter të ndërtesave shoqërore dhe të përshtatet me objektet për rreth .Inspirimi i formës është nga objektet e viteve të 50 ta- gjegjësisht nga Shkolla Teknike në pjesën veriore të qytetit të Mitrovicës .Objekti është me forma të pastra kubike . Forma e objektit ka rjedhur edhe nga vet funksioni i objektit dhe ndërlidhja e funksionevet në mes vete kanë bër që objekti të mer një form të till . Objekti është projektuar të ndërtohet në tri nivele: Bodrumit , Përdhesës dhe një Katë ku secila kanë funksionin e vet . Në kuadër të **Bodrumit** kemi këto hapësira : Depoja dhe kalldaja për ngrohje Trafostacioni , Stacioni i pompimit të ujit , Depoja për inventarin e vjetër , Depoja për inventarin e ri , Arkiva , Depoja e materialit shpenzues , Dhoma e mirmbajtësit , Tualetet , Komunikimi vertikal dhe ashensori . Në kuader të **përdhesës** kemi këto Hapësira : **Hyrja kryesore** , Erëmbrojtësi , Sigurimi , Koriri , Holli hyrës / Hapësira për shum qëllime , Dhjet klasa , Holli , Tualetet për femra , Tualetet për meshkuj , Tualetet për persona me aftësi të kufizuar , Kabineti i gjuhëve të huaja me depo për mjete , Kabineti i muzikës me depo për mjete, Kabineti i vizatimit me depo për mjete , Salla për kreativitet , Komunikimi dhe ashensori , Bifeja . **Hyrja ekonomike** Depo , Komunikimi dhe ashensori . **Hyrja administrative** , Salla e Arsimitarëve , Pedagogu , Psikologu , Salla për takime , Tualetet për femra , Tualetet për meshkuj . **Palestra** , Holli i palestrës , Dhoma e kujdestarit të sallës , Zhveshtorja për femra dhe tushi , Zhveshtorja për meshkuj dhe tushi , Tualetet për femra , tualetet për meshkuj , Depoja për pastruesin , Dhoma e mësimdhënësit , Salla , Depoja për mjete , Depoja për servisim . Në **katin e parë** kemi këto Hapësira : Holli dhe hapësira për shum qëllime , Holli , Dhjet klasa , Kabineti i kimisë , Kabineti i Fizikës , Kabineti i Biologjisë , Kabineti i Teknologjisë , Dhoma për servisim , Bibloteka , Tualetet për femra , Tualetet për meshkuj , Tualetet për persona me aftësi të kufizuar , Kounikimi dhe ashensori , Bifeja , Zyrja e drejtorit , Zyrja e Sekretarit , Zyrja për financa , Zyrja e Juristit , Arkiva , Tualetet për femra , Tualetet për meshkuj , Depo , Hapësira ekonomike .

6.2. IDEJA DHE KONCEPTI

Shkolla Fillore është paraparë për 400 nxënës me mundësi shtimi. Qëllimi kryesor ishte që të krijojmë hapësira komforte dhe të mjaftueshme të cilat shërbejnë për të kryer obligimet e nevojshem për secilin nxënës , ritjën e kualitetit të mësimit etj. Forma dhe idea për këtë objekt është bazuar në standardet ,normat dhe në ndërlidhjen sa më të mir të funksioneve në mes veti , duke i plotësuar të gjitha kushtet që të zhvillohet një mësim i mir për nxënësit që do të vijnë në mësimin aty . Sa i përket konceptit dhe formës së objektit frymëzim kan qenë shkollat e viteve të 50 ta , por një rol të madh në dukjën e objektit ka luajtur edhe vet funksioni . Si formë bazë në konceptimin e objektit janë marrë format e rregullta gjeometrike dhe me përdorimin e materjaleve sa më natyrore që të jenë në lidhshmëri me ambientin rrethues.

6.3. ETAZHITETI

Shkolla Fillore është paraparë të ketë etazhitet B+ P+1 .Bodrumi dysHEME -dysHEME 280 cm ; Përdhesa 360 cm ; Kati I 360 cm dhe salla e spoteve 550 cm .

6.4. DESTINIMI I SIPËRFAQEVE NË KUADËR TË PARCELËS

Hapësirat e gjelbëra dhe rekreative	7501.53m ²
Përdhesat	5912.5 m ²
Komunikimi	2950.28m ²
T O T A L	16364.31 m²/163.64 A

6.5. SIPËRFAQET E OBJEKTEVE

	BRUTO	NETO
BODRUMI	981.58m ²	948.95m ²
PËRDHESA	2152.26m ²	2056.51m ²
KATI I	2137.98 m ²	2040.14 m ²
SALLA	917.20 m ²	871.31 m ²
TOTALI	6189.02 m²	5916.91 m²

6.6. QASJA NË LOKACION

Qasja në objekt , hyrja kryesore për furnizim dhe hyraj per në parkingje të destinuara për ardhësit të gjitha bëhen nga ana Jugore . Hyrjet janë të theksuara dhe kontrollohen nga sigurimi .

6.7. KONSTRUKSIONI, MBULESA DHE MATERIALET

6.6.1 Konstruksioni: Sistemi konstruktiv për objektin në fjalë është përvetësuar ai skeletor. Sistemi skeletor është në harmoni me funksionin dhe arkitekturen e objektit ne fjal . Themelet në një pjes të objektit (pjesa e bodrumit) janë përvetësuar si themele Pllak Masive ndërsa pjesa tjetër e objektit ka themel të veqar me shputa të themelit 150/150 cm .Të gjitha konstruksionet meskatëshe janë përvetësuar sistem pllak masive, muret e jashtme janë me trashësi 25/20 cm dhe muratohen me blloqe te argjiles dhe pastaj bëhet izolimi termik me stiropor me trashësi 8 cm .

6.6.2 Mbulesa: Mbulesa e objektit është kulm i rrafshtë i cili ka ramje prej 2.1% ku lloji i kulmit është kulm i pa shfrytzuar . Kujdes të veqant i është kushtuar materialeve për izolim të kulmit , në mënyr që ti përballoj temperaturat e jashtme .

6.6.3 Fasada: - Fasada e objektit është e punuar nga shum shtresa që të ket izolim sa më të mir. Lloji i fasadës është fasada me tulla silikate ku i përmban këto shtresa : 1. Suvatim i brendëshëm / Llaqi i gëlqerës 1.5 cm; 2. Bllok Argjilor 25/20 cm ; 3. Lidhsja metalike nga qeliku anti korodus për perforcim të fasadës ; 4. Shtresa e ndalimit të avullit ; 5. Izolimi termik 8 cm ; 6.Rrjeta rabbit ; 7. Hapësira ventiluese 4 cm ; 8. Fasada me tulla silikate 12 cm .

6.6.4 Mveshjet finale të pllakave jashtë: Tek hyrja kryesore shkallët janë të mveshura me granit ndërsa pllatoja është e punuara nga pllaka nga betoni i thjesht .Ndërsa rrugët në obor dhe parkingjet janë të shtruara nga asfalti .

6.6.5 Mveshjet finale të dyshemeve brenda: Dyshemeja e përdhesës dhe katit përbëhen nga këto shtresa : 1. Dyshemeja / Epoxid 2 cm ; 2. Shtresa rafshuese / Estrihu 5 cm ; 3. Mbrojtës i termoizolimit / Folje PVC; 4. Termoizolimi / Stirodur / 8cm ; 5. Hidroizolimi 1cm ; 6. Pllaka / Beton Armi 20 cm . Hdërsa dyshemeja e bodrumit përbëhet nga këto shtresa : 1. Pllaka / keramik 1cm ; 2. Shtresa rafshuese / Estrihu 5 cm ; 3. Hidroizolimi 1 cm ; 4. Termoizolim / Stirodur 10 cm ; 5. Hidroizolim 1 cm ; 6. Themel Pllaka 60 cm ; 7. Shtresa rafshuese 5 cm ; 8. Hidroizolim 1 cm; 9. Shtresa rrafshuese 5cm ; 10. Zhavorr i ngjeshur 20cm ; 11. Toka mbajtëse .

6.6.6 Shkallët: Shkallët e brendshme janë të mveshura nga graniti artificial ndërsa rrethoja e shkallëve është e punuar nga alumini .

6.6.7 Dyert dhe Dritaret: Të gjitha dritaret në objekt janë nga materiali i aluminit me ngjyr hirt të mbyllt me dimensione 150 /150 , pjesa hyrëse në objekt dhe pjesa e hapësirës për shum qëllime është e mveshur me fasat strukturale . Dyert në objekt janë nga materilai i drurit (Bungut).Tek dritaret është përdorur xham i dyfishtë ku në pjesën e jashtme është xham i pastër me trashësi 4mm, si dhe pjesa e brendshme xham LOW-E 4mm, e që në mas të madhe ndikon në ruajtjen e energjisë.

6.7. IZOLIMI I OBJEKTIT

Izolimi termik tek niveli i themeleve është bërë nga TI i llojit “Stirodur” me trashësi 10cm. Izolimi termik tek kulmi i rrafshhtë është bërë nga TI i llojit “Stirodur ” me trashësi 8cm, si dhe izolimi termik i murreve të jashtme të objektit është bërë poashtu nga Ti "Stiopor "me trashësi 8cm. Hidroizolimi në nivelin e themeleve, kulmit të rrafshhtë si dhe pllakave të meskatit është HI “CONDOR” me trashësi 1 cm apo “INDEX”. Largimi i ujërave nëntokësorë bëhet nga gypi i drenazhës Ø100mm me ramje 2%.

6.8. PËRSHKRIMI I ENTERIERIT – KONCIPIMI I FUNKSIONEVE

Nga ana Jug-lindore bëhet shpërndarja e kthinave në objekt nga erëmbrojtësi dhe holi reprezentativ i pritjes/ Hapësira për shumë qëllime – hyrja kryesore. Klasat janë të lidhura me njëra-tjetrën në mënyrë gjatësore dhe ndahen në të dy anët e objektit .

Në pjesën balllore nga hyrja kryesore e objektit janë të vendosura shkallët në formë "U" me gjerësi 120cm të cilat mundësojnë lidhjen me etazhin pasues. Në pjesën balllore nga hyrja kryesore e objektit është hyrja në pjesën e administratës , bifeja për shënim të nxënësve , nyjet sanitare për femra , meshkuj dhe persona me aftësi të kufizuara . Si dhe në anën e majt të objektit kabineti i vizatimit , kabineti i muzikës, dhe dalja nga hapësira ekonomike, në anën e djathtë të objektit kabineti i gjuhëve të huaja , hapësira për kreativitet.Ndërsa në katin e sipërm nga komunikimi vertikal në anën e djathtë janë kabinetet e : Biologjis , Kimis , Fizikës dhe nyjet sanitare dhe në pjesën balllore klasat . Ndërsa në anën e majt janë kabineti i teknologjis , biblioteka , nyjet sanitare dhe në pjesën balllore klasat .

6.9. ORIENTIMI I KTHINAVE

Orientimi i kthinave është bërë sipas standardeve të kërkuara për ndërtesat shoqërore " Shkollat Fillore " ku si element kryesor klasat janë të orientuara në pjesën Jug - Lirjandore. Ndërsa Kabinetet , Hyrja ekonomike , Hyrja administrative ,Hapësirat për kreativitet dhe biblioteka në anën Veri - Perëndimore .

6.10. NDRIÇIMI, NGJYRAT

Duke pasur parasysh karakterin e objektit dhe se për qfar shërben ky objekt është më se e rëndësishme që të përdoret ndriçimi natyral në hapësirat si klasat, kabinetet, hapësirat për kreativitet, biblioteka dhe pjesa administrative . Në pjesën e tualeteve është përdorur ndriçim artificial . Në tërë objektin janë përdorur poca elektrike që jepin ngjyra portokalli aty ku gjenë përdorim është ngjyrë e cila nxit ndërveprimin social sepse hap urat e komunikimit ndërmjet njerëzve. Në të njëjtën kohë inkurajon respektin ndaj vetvetes si dhe ndaj të tjerëve.

7. REFERENCAT

- [1] " Historiku i shkollave" [<https://en.wikipedia.org/wiki/School>]
- [2] " Bousmaha Baich , Nicholas Walliman " Ernst and Peter Neufert : Architects` Data "
Third edition .
- [3] " Binak Beqaj " Projektimi i konstruksioneve arkitektonike" . Prishtin 2012 .
- [4] [Udhëzues për normat dhe standardet e ndërtesave shkollore]

8. BIBLIOGRAFIA

- [1] BINAK BEQAJ, Dr. Sc. , Libri Projektim i konstruksioneve arkitektonike.
- [2] Muhamet Ahmeti , ligjerata